



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.306/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e BIRN-it dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur Koalicioni PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.306/2017 e datës 12.06.2017, me të cilin është pretenduar se kandidati për deputet Evgjëni Thaçi-Drăgusha, nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka vazhduar sponzorimin e fushatës zgjedhore në Facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, BIRN-it dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 10.06.2017, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidati për deputet Evgjëni Thaçi-Drăgusha, nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka vazhduar sponzorimin e fushatës zgjedhore në Facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet si e bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar se shkelësi i supozuar e ka

vazhduar sponzurimin e fushatës edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 10.06.2017. Nga prova e ofruar nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklama e shkelësit të supozuar është publikuar në ditën e heshtjes zgjedhore sepse data dhe ora e paraqitur në fotografi, në shiritin e statusit të pajisjes (fusha e notifikimeve) nuk e dëshmon fakti se e njëjta është publikuar në ditën e heshtjes zgjedhore, ngase nga fotografia që është paraqitur reklama nuk ekziston data dhe ora e reklamimit-publikimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.306/2017 më datën 13.06.2017

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*

Kyesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

